



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 43, datë 21.05.2024

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VKB-NË NR. 196, DATË 22.12.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 666, datë 10.10.2019 ”Për kuotat financiare të ushqimit në bursat e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike” i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit nr. 63, datë 20.02.2024 “Për miratimin e shtyrjes së afatit të miratimit të vendimeve për bursat e nxënësve të arsimit profesional në Këshillin Bashkiak Durrës”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 331, datë 30.10.2023 “Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2023-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Tabelës nr. 2 të VKB-së nr.196, datë 22.12.2023, përsa i përket heqjes së bursës për nxënësin Ledjan Adem Rabdishti paraqitur në tabelën nr. 2 “Lista emërore e nxënësve të Shkollave të Mesme dhe konviktit “Benardina Qerraxhi”, me nr. rendor 124, si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Klasa	Data e largimit	Arsyeja e largimit
124	Ledjan Adem Rabdishti	11	17.04.2024	Arsye familjare

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.05.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 328 prot.

Durrës, më 29.05.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

DURRËS
29.05.24 N.5972/3

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.43 datë 21.05.2024 “Për e miratimin e një ndryshimi në VKB nr 196 dt 22.12.2023 “Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2023-2024 i ndryshuar”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

